




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPK</u>	Nr Prot. <u>03-02/4156/16</u>
Dep. <u>DPK</u>	Br Prot. <u>03-02/4156/16</u>
Nr. I faq. <u>02</u>	Data <u>03.11.2016</u>
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>03.11.2016</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>03.11.2016</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.11.2016, mori:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me Nr. *AKK-03-02-2969-16*, për Zyrtares e lartë z.*Doruntinë Matoshi-Anëtare e Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. *AKK-03-02-2969-16*, për Zyrtares e lartë, znj.*Doruntinë Matoshi-Anëtare e Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore*, dhe njëkohësisht person i autorizuar në bizneset private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj.*Matoshi* është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtarja e lartë, znj.*Matoshi* është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/3942/16) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se, znj.*Matoshi* tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar në biznes privat, duke emëruar një person të besuar në te, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

\_\_\_\_\_  
/ Shqip Haxho /

